



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Shkurt 2021

Nr: 21

VENDIM

**PËR REGJISTRIMIN E NISMËS LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR
KRIJIMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR TË AUTORËVE TË KRIMEVE
SEKSUALE”**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 4 pika 2 e 14 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” si dhe Udhëzimin nr.01, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J

Në datë 09.06.2020, Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse, zj. Iris Luarasi përfaqësuese e Qendrës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, zj. Ines Leskaj përfaqësuese e shoqatës “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” dhe zj. Mirela Arqimandriti përfaqësuese e Qendrës “Aleanca Gjimore për Zhvillim” kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesat nr.1149 prot., datë 09.06.2020 dhe nr.1149/1 prot., datë 18.06.2020 për pajisje me fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve për propozimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 13, datë 30.06.2020, vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas kërkesës së Komitetit përfaqësues për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale”.

Vendimi i sipërcituar ka përcaktuar afatin 4 mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për mbledhjen e nënshkrimeve. Afati përfundimtar për depozitimin e fletëve për mbledhjen e



Data: 2 Shkurt 2021

Nr. 21

Për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.

nënshkrimeve për t'u depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës është data 30.10.2020.

Në datën 29.10.2020A0 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar kërkesa për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin nr.13, datë 30.06.2020, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.19, datë 03.11.2020 vendosi të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale”, deri në datën 31 Dhjetor 2020.

Më datë 29.12.2020, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë protokolluar nënshkrimet e nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse.

Referuar nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, me depozitimin e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet, si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar për verifikimin e nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre, dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:

- a) regjistron nismën ligjvënëse të zgjedhësve;
- b) cakton një afat kohor për plotësimin ose korrigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve;
- c) refuzon regjistrimin e nismës nëse nga verifikimi rezulton se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën, duke depozituar identitetin dhe firmat e tyre, është më i vogël se 20 000 zgjedhës.

Në zbatim nenit 7, pika 1 të Udhëzimit nr.01, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri ftoi përfaqësuesit e komitetit nismëtar zj. Iris Luarasi, zj. Ines Leskaj dhe zj. Mirela Arqimandriti, të jenë prezent në seancën publike për verifikimin e numrit të nënshkrimeve.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ka bërë verifikimin e 5 për qind të listës mbështetëse si dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, brenda afatit ligjor të parashikuar. Në total janë depozituar 960 fletë, nga ku rezulton se 22 428 nënshkrime janë të rregullta dhe 1 572 janë me gabime ose mungesa.



Data: 2 Shkurt 2021
Nr. 21

Për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.

Në bazë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet që nisma ligjvënëse të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës. Ka rezultuar se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën e plotëson numrin prej 20 000 zgjedhës.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 14, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” si dhe Udhëzimin nr.01, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nënshkrimet e depozituara nga përfaqësuesit e nismës ligjvënëse për të propozuar projektligjin “Për krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale” janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe si të tilla duhet të pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe neni 14, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 90 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S:

- 1- Regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale”, propozuar nga Qendra “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” dhe Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

